

Titulli i Projektit **RIKONSTRUKSIONI I BASHKISE,
PATOS**

Vendndodhja **Lagjia: "NAFTETARI", rruga UNAZA
Bashkia Patos**

PJESA A- SPECIFIKIME TEKNIKE TE PERGJITESHME

Seksioni	Permbajtja	
Seksioni 1	Kerkesa te Pergjitheshme te Kontrakorit	√

2015

Permbajtja

1.1 Objekti i Aktiviteteve	3
1.1.1 Pershkrim i Permbledhur i Projektit	Error! Bookmark not defined.
1.1.2 Objekti i Kontrates	3
1.1.3 Relacionet mes Kontratave te Ndryshme	3
1.2 Detyrime te Pergjitheshme	3
1.2.1 Energjia elektrike, Uji	3
1.2.2 Stafi dhe Personeli i Te Kontraktuarit	3
1.2.3 Kushtet e Punes	3
1.2.4 Rregullat mbi Sigurine ne Pune dhe Rregulli i Pergjithshem ne Site	3
1.2.5 Standartet, Peshat, dhe Masat, Shkurtime, Etiketimi dhe Simbolet	4
1.2.6 Sherbimet e perkoheshme per kontrollin e trafikut	4
1.2.7 Punimet per drenazhimin e perkohshem	4
1.2.8 Germimet e hapura	4
1.2.9 Pastrimi ne Site	5
1.2.10E drejta e Autoritetit Kontraktues per te pastruar	5
1.3 Detyrime te Vecanta	5
1.3.1 Programi i Punimeve	5
1.3.2 Studimi i Site, projekti dhe llogaritjet per punimet e ndertimit	5
1.3.3 Pregatitja e projekteve As-built	6
1.3.4 Kapaciteti teknik dhe kontrolli i cilesise	6
1.3.5 Takimet ne Site	6
1.3.6 Mbrojtja e Punimeve	7
1.3.7 Masat per Sigurine	7
1.3.8 Mbrojtja e Pemeve dhe Zonave te Gjelberuara	8
1.3.9 Dokumentacioni mbi Site dhe fotografite e progresit te Punimeve	8
1.5 Masat e nevojshme per Mbrojtjen	9
1.5.1 Te pergjitheshme	9
1.5.2 Sherbimet Nentokesore	9
1.5.3 Kujdesi per muret kufizuese dhe Rrethimet	10
1.5.4 Mbrojtja e Pasurise	10
1.6 Materialet dhe paisjet, aprovimet dhe zevendesimet	11
1.6.1 Te pergjitheshme	11
1.6.2 Zevendesimet	11
1.6.3 Ruajtja dhe Mbrojtja e Paisjeve dhe Materialeve	12
1.6.4 Instalimi dhe Testimi i Paisjeve dhe Punimeve	12
1.7 Çeshtje qe kane te bejne me Ambjentin	13
1.8 Kerkesat per Matjen, Pagesen dhe Miratimin	13
1.8.1 Matja	13
1.8.2 Pagesat e Ndermjetme	13
1.8.3 Çertifikata e perfundimit te punimeve	14
1.8.4 Pranimi perfundimtar	14

Perkufizimet

- Punedhenesi:** Autoriteti pergjegjese per firmosjen e kontrates.
- Supervizori :** Perfaqesuesi i Punedhenesit, pergjegjes per kontrollin, testimin, matjen dhe per te garantuar zbatimin e sakte te punimeve.
- I Kontraktuari:** Kompania ose grupi i kompanive qe eshte zgjedhur per zbatimin fizik te punimeve.

SEKSIONI 1– KERKESA TE PERGJITESHME

1.1 Objekti i Aktiviteteve

1.1.2 Objekti i Kontrates

Ne aktivitetet e projektit perfsihet furnizimi i te gjitha punimeve, impianteve & paisjeve, materialeve te kerkuara, siç jane percaktuar ne dokumentat e tenderit, si dhe skicat/projektet per te kompletuar te gjitha punimet e kerkuara, para-identifikimin, identifikimin, testimin, rehabilitimin e Siteve, pregatitjen e punimeve, projekteve te kantierit dhe mbeshtetja e kompanise Projektuese ne realizimin e projekteve as-built (sikurse ndertuar).

Te gjitha punimet do te jene siç jane percaktuar ne detaje ne Specifikimet Teknike Specifike dhe sikurse jane paraqitur ne Projektet.

1.1.3 Relacionet mes Kontratave te Ndryshme

I Kontraktuari duhet te beje te qarte ne se ndonje institucion, organizate apo tjetër, jane duke kryer ose do te kryejne ndonje pune apo aktivitet paralelisht me punen e te Kontraktuarit dhe duhet te koordinoje punen e tij me ato.

1.2 Detyrime te Pergjitheshme

1.2.1 Energjia Elektrike, Uji

I Kontraktuari do te jete pergjegjes per te furnizuar perkohesisht me energji elektrike dhe uje gjate gjithë kohezgjatjes se zhvillimit te punimeve. I Kontraktuari do te marre te gjitha lejet e nevojshme dhe do te paguaje kostot e energjise elektrike dhe te ujit te nevojshme per kete Kontrate.

Materialet, paisjet dhe instalimi duhet t'i permbahen kushteve te rregulloreve nacionale.

1.2.2 Stafi dhe Personeli i Te Kontraktuarit

I Kontraktuari do te siguroje te gjitha zyrat e nevojshme, ambjentet sociale, strehimin dhe sherbime te tjera te nevojshme per stafin e vet si dhe per çdo personel tjetër ne kuadrin e punimeve te supervizionit per kete Kontrate.

1.2.3 Kushtet e Punes

Puna do te kryhet gjate orarit normal te punes dhe, ne se ne raste jo te zakonshme kryhet pune jashte orarit, atehere per zhvillimin e kesaj pune si dhe te supervizionit duhet te arrihet paraprakisht ne marrveshje me inspektorin e ADF;
I Kontraktuari do te organizoje Sito-n si dhe menytrat e tij te punes ne menyre te tille qe te gjithë te jene te siguar;

1.2.4 Rregullat mbi Sigurine ne pune si dhe Rregulli i Pergjithshem ne Site

I Kontraktuari do te jete plotesisht pergjegjes per respektimin e te gjitha rregullave mbi sigurine si dhe te kerkesave per rregullin e pergjithshem ne Site, ne perputhje me ligjet ne zbatim, rregulloret dhe udhezimet e autoriteteve lokale si dhe sikurse jane percaktuar ne Kontrate.

1.2.5 Standartet, Peshat dhe Masat, Shkurtime, Etiketimi dhe Simbolet

Per te gjitha materialet dhe paisjet do te perdoren standartet metrike/SI nderkombetare ne lidhje me peshat apo me dimensionet e tyre.

Standartet dhe normat Shqiptare do te perdoren sa me shume qe te jete e mundur. Sa here qe te perdoren standarte te tjera si per shembull Standarte Europiane, mallra, materiale, pune krahu, te cilat kane standarte te tjera te ligjeruara, dhe qe garantojne ne menyre esenciale cilesi te njejte ose me te larte se standartet Nacionale, ato gjithashtu do te pranohen me kusht qe Supervizori t'i kete shqyrtuar dhe te kete dhene leje me shkrim paraprakisht.

1.2.6 Sherbimet e perkohshme per kontrollin e trafikut

I Kontraktuari do te siguroje, krijojte dhe mirembaje te gjitha paisjet e nevojshme per kontrollin e trafikut, sinjalet rrugore, barrikatat, shenjat paralajmeruese si dhe shenimin e rrugeve siç eshte e nevojshme per sigurine e njerezve si dhe per mbrojtjen e punimeve, dhe do t'i eliminoje ato kur te mos jene me te nevojshme. Do te jete pergjegjesi e Te Kontraktuarit qe te marre masa qe te gjitha paisjet e siperpermendura per kontrollin e trafikut te jene te pranishme gjate gjithë kohes dhe te funksionojne siç duhet.

1.2.7 Punimet per drenazhimin e perkohshem

I Kontraktuari do te ndertoje te gjitha veprat provizore per drenazhim siç jane drenazhet anesore, pusetat, kanalet e shkarkimit, etj, me qellim qe te trajtohet siç duhet çdo grumbullim i ujrave ne siperfaqe.

Pusetat e perkohshme te tipit dhe dimensioneve qe percaktohen nga Supervizori do te instalohen ne kanalet ekzistuese te drenazhimit sa here qe te kerkohet nga Supervizori. Pusetat e parafabrikuara e adeqate qe mund te jene rekuperuar nga nje rruge ekzistuese apo nga nje rruge alternative e braktisur, mund te perdoren serishmi ne se jane ne gjendje te mire dhe ne se kjo miratohet nga Supervizori.

1.2.8 Germimet e hapura

Per te gjitha germimet e gropat e hapura do te merren masa mbrojtese adeqate gjate gjithë kohes duke krijuar barrikada provizore, sinjale paralajmeruese, kone (shenja rrugore te levizeshme) dhe sinjalizime te pershtateshme per te parandaluar aksidentet ne njerez si dhe demtimet e pasurise. Te gjitha sinjalet me shkrim do te jene ne gjuhen Shqipe dhe do t'i permbahen rregulloreve te Autoriteteve Lokale.

I Kontraktuari do te marre masa qe te parandaloje demtime te publikut per shkak te transeve te hapura, materialit te germimit, paisjeve, apo pengesave te tjera qe mund te jene te rrezikshme per publikun, te cilat do te rrethohen me gardhe adeqate dhe do te ndriçohen siç duhet qe gjysem ore para perendimit te diellit deri gjysem ore mbas lindjes se tij, si dhe ne çdo kohe tjeter kur vizibiliteti eshte i kufizuar. Pozicioni dhe numuri i llampave do te jete i tille qe te siguroje vizibilitetin e qarte te pozicionit dhe shtrirjes se punimeve.

1.2.9 Pastrimi ne Site

I Kontraktuari duhet te zhvendose nga site dhe te depozitoje ne nje vend te miratuar te gjitha mbetjet, materialet e skartuara si dhe pleherat qe jane gjeneruar gjate punes se tij.

I Kontraktuari do te pastroje me kujdes dhe do te eliminoje te gjitha mbeturina suvatimi, mbeturina betoni, pikat e mbeshtetjes se skelave, mbeturinat e lysterjeve.

Pas perfundimit te punes, I Kontraktuari do te heqe te gjitha pleherat dhe mbeturinat materiale nga Site duke perfshire te gjitha strukturat provizore, sinjalet e ndertimit, veglat e punes, skelave, materialet, furniturat dhe makinerite apo paisjet e ndertimit qe mund te jene perdorur nga ai vete apo nga ndonje sub-kontraktor i tij gjate realizimit te punimeve. I Kontraktuari do te pastroje gjithë Vendin e Punimeve dhe do te lere Site ne gjendje krejtesisht te paster.

Ne rast se kemi te bejme me nxjerrje materialesh nga nje shtrat lumi apo nga hapja e kavave te materialeve I Kontraktuari, me shpenzimet e tij, do te ri-niveleje siperfaqen e huazuar dhe do te ri-sjelle ne gjendje te mire pendencat, pikat e karrierve.

1.2.10 E drejta e Autoritetit Kontraktues per te Pastruar

Ne se i Kontraktuari nuk realizon, refuzon ose neglizhon heqjen e pleherave dhe te materialeve mbeturina, si dhe punen provizore apo pastrimin e zonave te shtruara apo te trotuarave per kalimtare sikurse kerkohet ne kete dokument, atehere, Autoriteti Kontraktues do te heqe dhe eliminoje ato plehera dhe materiale mbeturina, si dhe do realizoje punen provizore apo pastrimin e zonave te shtruara apo te trotuarave per kalimtare, duke zbritur koston perkatese nga fondet per te cilat i detyrohet ose do t'i detyrohej te Kontraktuarit sipas kesaj Kontrate.

1.3 Detyrime te Veçanta

1.3.1 Programi i punimeve

Jo me pak se nje muaj me pare se ka planifikuar te filloje ndertimin, si dhe duke u bazuar ne rezultatet e vizitave ne site, I Kontraktuari do t'i paraqese Supervizorit per miratim programin e azhornuar te punimeve, i cili do te percaktoje se ne ç'menyre I Kontraktuari merr persiper te perfundoje punimet brenda kohes se duhur.

Ne se Supervizori miraton nje program punimesh, kjo nuk e kufizon ate nga e drejta qe te udhezoje te Kontraktuarin qe ta ndryshoje programin ne se kjo diktohet nga rrethanat.

1.3.2 Studimi i Site, projekti dhe llogaritjet per punimet e ndertimit

Para se te fillojne punimet dhe jo me vone se nje muaj para dates qe planifikon te filloje punimet, I Kontraktuari do te kryeje nje studim topografik te plote ne site dhe ne zonat ku do te kryhen punimet, ne vendndodhjet si dhe ne masen qe do te percaktohen nga Supervizori. Nivelet, dimensionet dhe pjerresite e transheve do te kontrollohen nga nje ekip topografik me eksperiencen e duhur, me shpenzimet e te Kontraktuarit dhe nen pergjegjesine e Supervizorit.

Ne baze te ketij studimi I Kontraktuari do te pregatise projektet e detajuara qe paraqesin zonen e punimeve si dhe karakteristikat e dimensionet e infrastrukturave qe do te

ndertohen. I Kontraktuari do te jete pergjegjes per azhornimin e projekteve gjate periudhes se ndertimit, ne menyre qe te marre ne konsiderate ndryshimet e mundeshme te karakteristikave te punimeve per shkak te kushteve te vecanta qe mund te paraqiten ne site.

Ne rast te nje Urdheri per Variacion, I Kontraktuari do te pregatise projektet dhe analizen e kostove qe do t'i paraqiten Supervizorit per miratim. Mbas perfundimit te punimeve, I Kontraktuari do te pregatise projektin as-built.

Ne se ne punimet jane perfshire struktura ne betonarme, I Kontraktuari do te paraqese projekte e llogaritje specifike per kollonat prej betonarme sipas standarteve Shqiptare ose Europiane.

Te gjitha projektet e dokumentat e ndertimit do te miratohen nga Supervizori dhe I Kontraktuari nuk do te filloje ndertimin para se te jene miratuar projektet. Projektet dhe llogaritjet e miratuara nga Supervizori do te konsiderohen si projekti i miratuar per zbatimin e punimeve. I Kontraktuari do te jete pergjegjes per llogaritjen e strukturave ne betonarme.

1.3.3 Pregatitja e projekteve te zbatimit.

Autoriteti Kontraktues do te paise te Kontraktuarin me nje komplet te plote Projektesh.

I Kontraktuari do te mbaje ne site nje komplet te shtypur projekteve te ndertimit. Mbi keto projekte te shtypura do te behet ne menyre te perdritshme nje regjistrim me boje te kuqe i te gjitha punimeve te instaluara si dhe i te gjitha modifikimeve apo ndryshimeve te bera ne to. Ky komplet I shtypur do te jete ne dispozicion ne çdo kohe per qellime inspektimi.

Te gjitha punimet e instaluara te modifikuara do te pasqyrohen ne projektet as-built ne nje shkalle te pakten te barabarte me shkallen e Projekteve. I Kontraktuari do te pregatise me shpenzimet e veta planin e zbatimit.

Me pagesen e fundit, I Kontraktuari do t'i dorezoje Autoritetit Kontraktues, te shoqeruar me nje format te riprodhueshem te tyre, projektet as-built, ne shkallen e projekteve fillestare, ne te cilet jane pasqyruar dhe modifikimet eventuale, detajet qe kane te bejne me projektin e zbatuar si dhe çdo informacion per kete projekt.

1.3.4 Kapaciteti teknik dhe kontrolli i cilesise

I Kontraktuari mbart pergjegjesine qe te kryhet nje pune e cila ploteson kushtet e cilesise dhe te saktetise se detajeve qe jane percaktuar ne kerkesat e Specifikimeve dhe Projekteve, dhe I Kontraktuari do te krijoje me shpenzimet e veta nje sistem per kontrollin e cilesise si dhe do te ofroje sherbimin e inxhinjereve me pervoje, drejtuesve, supervizoreve, teknikeve te materialeve dhe te tjere punonjes, se bashku me te gjitha instrumentat dhe paisjet e transportit, per te garantuar nje kontroll adeguat dhe pozitiv te punimeve ne çdo kohe.

Kur te kerkohet nga Supervizori, I Kontraktuari do te realizoje testet ose, do te dergoje me shpenzimet e veta ne nje laborator te specializuar, te gjitha kampionet e kerkuara nga keto Specifikime, dhe ai do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise se punimeve nga ana e tij. Per analizat laboratorike, nga I Kontraktuari do t'i dorezohen Punedhesisit dhe Supervizorit dy kopje te rezultateve te çdo testi te realizuar.

1.3.5 Takimet ne Site

I Kontraktuari do te marre pjese ne takimet ne site me perfaqesues te Punedhesisit dhe Inxhinjerit, ne datat dhe oren qe do te percaktohen nga Punedhesisit. Keto takime do te zhvillohen per te analizuar procesin e Kontrates dhe per te diskutuar mbi çeshtjet qe cilado nga palet perfaqesuese mund te deshiroje te ngreje ne lidhje me Kontraten. Keto takime nuk do kene si qellim diskutimin e çeshtjeve qe lidhen me zbatimin normal e hap pas hapi te Kontrates.

Nje frekuence minimale takimesh do te realizohet çdo muaj dhe ne çdo rast, kjo frekuence do te jete adequate per kohezgjatjen e parashikuar te punimeve.

1.3.6 Mbrojtja e punimeve

Ne detyrimet e pergjitheshme te Te Kontraktuarit, ndermjet te tjerave do te perfshihen edhe:

- (a) Te kryeje punime per drenazhim provizor siç jane drenazhet, hapja e kanaleve, bankinat, etj, dhe te siguroje e te vere ne sherbim pompa provizore si dhe çdo paisje tjeter qe mund te nevojitet per nje mbrojtje, drenazhim dhe kullim sa me adequat te Vepres si dhe te punimeve provizore. Keto jane aktivitete te tjera qe do te zhvillohen ne shtese te atyre qe kane te bejne me punimet per drenazhimin permanent te specifikuar dhe te instaluar si dhe te atyre per punime drenazhimi provizor te cilat do te paguhen ne menyre specifike veçmas, si per shembull ne rastin e punimeve per devijacionet.
- (b) Te kujdeset per mbrojtjen e te gjitha pjeseve te punes nga erozioni, permytjet dhe reshjet.

Kur materiali te jete shperndare mbi siperfaqet e rrugeve, I Kontraktuari duhet te garantoje qe gjate periudhes se shirave do te kete nje evadim te mire te ujrave si dhe nje ngjeshje te lehte mbi siperfaqe per te ndihmuar rrjedhjen e ujrave gjate stines se shirave.
- (c) Profilat e skarpatave per rruget do te riparohen menjehere kur ato demtohen nga ujerat siperfaqesore. Kur kemi te bejme me skarpata te larta, pendencat do te riparohen nepermjet strukturave te kullimit per te formuar shkallezime si dhe duke ngjeshur mekanikisht deri ne arritjen e densiteteve specifike te kontrolluara, duke perdorur paisjet e pershtateshme me peshe te lehte.
- (d) Germimet per tubacione, drenazhe, puseta, kolektore sherbimi dhe struktura te ngjashme do te mbrohen ne menyre adequate nga infiltrimi i mundshem i ujrave gjate rebesheve.
- (e) Te gjitha punimet e perfunduara per shtrimin e rrugeve do te mbrohen dhe mirembahen deri sa te jete perfunduar shtruarja tjeter. Ne mirembajtje do te perfshihet riparimi i menjehershem i demeve apo difekteve, gje qe do te ndodhe dhe perseritet aq here sa te jene te nevopjshme per te ruajtur vazhdimisht te paprekur dhe ne gjendje te mire shtresen.
- (f) Puna e kryer si pjese e detyrimeve te mesiperme nuk do te matet dhe paguhet veçmas, dhe kostot perkatese do te pefshihen ne çmimet e ofruara ne tender per elementet e ndryshme te vepres.

1.3.7 Masat per sigurine

I Kontraktuari duhet te permbushe kushtet e kerkuara per sigurine sipas organizmave dhe/ose dokumentave qe vijojne:

- Organizata e Republikes se Shqiperise per Sigurine

Specifikimet Teknike	Pjesa A	Seksioni 1-Specifikime te Pergjitheshme		Faqja 7 nga 15
----------------------	---------	---	--	----------------

1.3.7.1.-Paisjet per Sigurine Personale

I Kontraktuari do te paise personelin e vet me paisjet e duhura per sigurine, siç jane helmetat, kepuçet mbrojtese, dorezat, veshjet e padepertueshme nga uji, maska kunder pluhurit dhe rripat mbrojtese. Perdorimi i ketyre paisjeve eshte i detyrueshem.

1.3.7.2- Bllokimi i Pluhurit

Gjate zhvillimit te punimeve dhe te çdo operacioni per kete qellim, I Kontraktuari do te zbatoje masat e duhura dhe efikase, siç eshte sperkatja me uje apo me menyra te tjera kurdohere dhe kudo qe eshte e nevojshme per te reduktuar shqetesimet qe krijohen nga pluhuri, dhe per te mos lejuar qe pluhuri qe krijohet nga keto operacione te demtoje bimet, arat e kultivuara dhe te vjelat, ose te shkaktoje shqetesime tek njerezit.

1.3.7.3-Kufizimi i zhurmes

Gjate zbatimit te punimeve dhe te çdo operacioni perkates per kete qellim, I Kontraktuari do te zbatoje masat e duhura dhe efikase me qellim qe te reduktoj shqetsimet per shkak te zhurmes, qe mund te krijohet nga perdorimi i paisjeve te ndryshme dhe motorave. Nuk lejohet I Kontraktuari qe te perdore paisje te tilla ndermjet oreve 18.00 dhe 7.00.

1.3.8 Mbrojtja e Pemeve dhe Zonave te Gjelberuara

Nuk do t'i lejohet Te Kontraktuarit te heqe, rivendose apo te prese pemet qe gjenden ne zonat publike, me perjashtim te rasteve kur ka marrveshje ndermjet Autoriteteve Lokale, pronarit dhe Supervizorit per kete. Eshte pergjegjesi e Te Kontraktuarit qe te mbroje te gjitha pemet ekzistuese dhe siperfaqet e gjelberuara ne zonen ku zhvillohen punimet. Ne se ato pa qene nevoja shkatërrohen apo demtohen ne njefare mase nga I Kontraktuari, atehere ai do te zevendesoj pemet e demtuara dhe/ose zonen e gjelberuar me te reja qe kane te njejten cilesi dhe karakteristika, qe i pergjigjen plotpelqimit te Supervizorit te Autoritetit Kontraktues.

1.3.9 Dokumentacioni mbi Site dhe fotografite e progresit te Punimeve

Nje panel standart 2*2 per punimet duhet te instalohet nga ana e Te Kontraktuarit qe ne fillim si dhe per gjithe kohezgjatjen e Punimeve. Kosto e blerjes dhe instalimit do te perballohet nga vete I Kontraktuari. Nga ana e Autoritetit Kontraktues do te jepet nje model qe inkuadron ne vetvete te gjithe permbajtjen qe duhet te pasqyrohet ne te.

I Kontraktuari do te garantoje qe dokumentacioni mbi Punimet mbahet dhe azhurnohet ne menyre te vazhdueshme. Ne kete dokumentacion do te perfshihen puna, impianti, materialet ne site, germimet, punimet shtese te urdheruara, etj....

I Kontraktuari do te beje nje seri fotografish me ngjyra qe ilustrone progresin e punimeve. Fotografite do te pasqyrojne pamje perfaqesuese nga Punimet si perpara fillimit, gjate progresit ashtu dhe ne perfundim te tyre.

Negativat e filmit do te etiketohen siç duhet dhe do t'i dorezohen Autoritetit Kontraktues. Ne se perdoret nje aparat fotografimi dixhital, dokumentet ne format elektronik JPEG do te dorezohen ne CD-ROM, bashke me nje dokument ne format Word duke perfshire edhe nje liste te plote te te gjitha fotografive e pamjeve te marra, ne se keshtu kerkohet.

1.5 Masat e nevojshme per Mbrojtjen

1.5.1 Te pergjitheshme

I Kontraktuari do te jete pergjegjes per mbrojtjen nga aktet vandale, vjedhjet apo demtimet malicioze te te gjitha Sherbimeve, per te gjithë kohen, qe nga fillimi i kryerjes se punimeve.

1.5.2 Sherbimet Nentokesore

1.5.2.1-Te pergjitheshme

Para se te filloje ndertimi ne Site, I Kontraktuari duhet te organizoje bashke me Autoritetin Kontraktues dhe pronaret e sherbimeve nentokesore, demonstrimin dhe/ ose vendosjen e sherbimeve ne menyre te tille qe te evitohen demtimet gjate punimeve te ndertimit.

1.5.2.2-Sherbimet e Panjohura Nentokesore

1. I Kontraktuari do te ndermarre te gjitha masat e nevojshme per te garantuar qe sherbime eventuale te panjohura nentokesore qe mund te ndodhen brenda si dhe afer kufijve te germimeve, te zbulohen ne kohe dhe te ruhen nga demtimet.
2. Ne se, edhe pse keto masa mund te jene marre, ndodhin demtime ne sherbime te panjohura nentokesore, I Kontraktuari duhet te marre masat e duhura per te minimizuar keto demtime dhe te informoje menjehere Supervizorin dhe pronarin apo Autoritetet Pergjegjese.
3. Ne çdo menyre, ne se I Kontraktuari nuk merr masat e duhura dhe ndodhin demtime ne sherbime te panjohura nentokesore per shkak te kesaj neglizhence, atehere I Kontraktuari do te konsiderohet pergjegjes per zhdemtimin e demit te bere njesoj sikur prania e atyre sherbimeve te ishte e njohur qe me pare.

1.5.2.3-Sherbimet e Njohura

1. I Kontraktuari do te marre te gjitha masat per te garantuar qe te gjitha sherbimet ekzistuese te njohura, tubacionet, pusetat, kabllot, muret kufizuese dhe barrierat, muret mbajtese, drenazhet dhe kanalet ujtese e te tjera si keto, qe ndodhen brenda dhe afer kufijve te germimeve jane identifikuar, suportohen dhe ruhen nga demtimet. Cdo lloj demtimi qe mund te shkaktohen ne sherbime te tilla si tubacionet, pusetat, kabllot, muret kufizuese dhe barrierat, muret mbajtese, drenazhet dhe kanalet ujtese e te tjera si keto, qe mund t'i atribuohen operacioneve te Te Kontraktuarit, trafikut te tij te punimeve te ndertimit apo neglizhences se tij, do te zhdemtohen nga I Kontraktuari ose ne emer te tij, me shpenzimet e tij deri ne arritjen e plotpelqimit te pronarit ose Autoriteteve Pergjegjese.
2. Ne rast se do te jene pronari ose Autoritetet Pergjegjese ata qe do vendosin se kush do t'i riparoje demet, I Kontraktuari duhet te mbuloje kostot e kryerjes se punes. Ne se I Kontraktuari nuk paguan per keto kosto brenda nje periudhe kohe te arsyeshme mbas paraqitjes se fatures perkatese dhe koordinatave bankare, Autoriteti Kontraktues rezervon te drejten te mbylle llogarine dhe te zbrese shumen e paguar prej tij nga fondet qe duhet t'i kalonin Te Kontraktuarit.

1.5.2.4 Heqja e Perkohshme e Sherbimeve Ekzistuese

1. Ne se per nje zbatim te mire te punimeve do te behet e nevojshme qe te eliminohet apo te devijohet ndonje rruge, tubacion, kanal i ujrave te zeza, kanal drenazhimi apo ujitje apo çdo sherbim tjetër ekzistues, I Kontraktuari duhet te marre lejen nga Autoritetet Pergjegjese apo nga pronari dhe do te kryeje punen me shpenzimet e tij ne ate menyre

dhe ne ato afate qe do te miratohen nga ai Autoritet apo pronar, duke risjelle me pas veprat ne gjendjen fillestare, per te arritur plotpelqimin e atij Autoriteti apo pronari.

2. Ne rast se pronari apo Autoritetet Pergjegjese vendosin qe te organizojne ata vete heqjen e perkoheshme te nje sherbimi ekzistues, I Kontraktuari do te perballoje koston e kesaj pune. Ne se I Kontraktuari nuk paguan kete kosto brenda nje kohe te caktuar mbas paraqitjes se fatures perkatese dhe koordinatave bankare, Autoritetet Kontraktuese rezervojne te drejten qe te mbyllin llogarine dhe te zbresin shumen e paguar nga fondet qe duhet t'i kalonin ose t'i kalojne Te Kontraktuarit.
3. Nje vemendje te vecante I Kontraktuari duhet t'i kushtoje nevojës per te mirembajtur kanalet e drenazhimit e te ujitjes duke evituar qe te ndodhe ndonje nderprerje e rrjedhjes se ujrave, e furnizimit me energji elektrike, aksesit ne shtepite private, ndertesat apo garazhet ne to, duke arritur ne kete menyre permbushjen e kerkesave te popullsisë, pronareve apo Autoriteteve Pergjegjese. Do te konsiderohet se I Kontraktuari i ka perfshire keto kosto ne tarifat dhe çmimet e tij per te gjitha punimet provizore te nevojshme.

1.5.3 Kujdesi per Muret Kufizuese dhe Rrethimet

I Kontraktuari nuk do te shkurtoje apo heqe ndonje pjese te ndonje muri kufizues apo rrethimi pa marre me pare lejen nga pronari.

Shkurtimi apo eliminimi i mureve kufizuese dhe barrierave, qe mund te jene te nevojshem per te realizuar zgjerimin e nje rruge apo nje forme te caktuar te saj, normalisht do te kufizohen vetem ne rastet kur keto pershkojne rrugen e tubave kryesore dhe tubacioneve te tjera per furnizimin me uje, apo per rrjetet e kanaleve te ujrave te zeza. Keshtu, I Kontraktuari do t'i drejtoje operacionet e tij per te minimizuar permasat e ketyre shkurtimeve apo heqjeve.

I Kontraktuari do te rindertoje ose ringreje çdo mur apo rrethim qe ai mund te kete shkurtuar apo demtuar gjate operacioneve te tij, ne menyre te ngjashme me formen e tyre origjinale ose ne menyra te tjera te miratuara. Te gjitha keto riparime dhe rindertime do te jene pergjegjesi e vetme e Te Kontraktuarit dhe do te realizohen ne menyre te tille qe te arrijne plotpelqimin e pronarit dhe Autoritetve Pergjegjese.

I Kontraktuari, me shpenzimet e tij, do te krijojë rrethime provizore dhe do te marre masa sigurie ne çdo kohe per te mbrojtur pasurite e prekura nga ky proces.

1.5.4 Mbrojtja e Pasurise

I Kontraktuari do te jete pergjegjës per ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurise, private ose publike, ne Vendin e punimeve ose afer tij, kunder demtimeve e shkaterrimeve si pasoje e operacioneve te tij ne kuadrin e kesaj Kontrate.

Cdo demtim ose shkaterrim qe ndodh per shkak te nje veprimtarie, gabimi, apo neglizhence nga ana e Te Kontraktuarit do te ri-sillet ne nje gjendje te mire dhe te pranueshme ose do te zevendesohet teresisht me nje tjetër qe ka te njejten cilesi ose cilesi me te larte se ajo ekzistuese e meparshme, me shpenzimet e Te Kontraktuarit.

I Kontraktuari do te ri-rregulloje te gjitha siperfaqet dhe pasurite e demtuara apo qe jane prekur nga operacionet e tij. Ai do te mbaje pergjegjesi te plote per mbrojtjen e te gjitha siperfaqeve te jashtme e te brendeshme te perfunduara, impiantet e paisjet e instaluara nga

njolloset, shenjat, papastertite ose demtime te çdo lloji, qe nga koha e ndertimit te tyre, perfundimit, apo instalimit deri ne kohen e dorezimit.

Ne rast se ka ankesa per demtime, apo per deme te supozuara mbi pasurine si rezultat i punimeve ne kuadrin e kesaj Kontrate, I Kontraktuari do te jete pergjegjes per te gjitha kostot qe kane te bejne me keto ankesa. Perpara se te filloje puna ne afersi te pasurise qe ndodhet ngjitur me Siton ku do te zhvillohen punimet, I Kontraktuari duhet te zhvilloje me shpenzimet e veta te gjitha studimet e nevojshme per te percaktuar gjendjen ekzistuese te pasurise. Perpara leshimit te çertifikates finale, I Kontraktuari duhet t'i paraqese Autoritetit Kontraktues prova te mjaftueshme qe te gjitha ankesat per demtime jane zgjidhur ligjerisht.

1.6 Materialet dhe paisjet, aprovimet dhe zevendesimet

1.6.1 Te pergjitheshme

I Kontraktuari do te percaktoje materialet dhe paisjet e veçanta qe ai ofron per te permbushur Specifikimet Teknike. Ai duhet te paraqese gjithashtu Kataloget e Prodhimit, te dhenat teknike dhe kur eshte e nevojshme edhe kampione. Ky dokumentacion teknik do te perdoret si dokumentacion mbeshtetes per aprovimin e listave te materialeve dhe paisjeve qe duhet te furnizohen/ndertohen.

1.6.2 Zevendesimet

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe, te gjitha materialet dhe paisjet e perfshira ne punimet sipas kesaj Kontrate do te jene te reja.

Ne punimet do te perdoren vetem ato produkte qe jane specifikuar qe ne fillim dhe/ose jane aprovuar sipas kerkeses se Te Kontraktuarit per zevendesime. Sa here qe te aprovohen kerkesa per zevendesime, do te konsiderohet qe aprovimi eshte i kushtezuar nga permbushja e plote e te gjitha kerkesave ne Kontrate dhe, pas kesaj, nga kushtet qe vijojne:

- Duhet te jete i barabarte me artikullin e specifikuar per nga forca, jetegjatesia, efikasiteti, dobishmeria, pershtatshmeria me sistemet ekzistuese, lehtesia e mirembajtjes dhe kostot e saj; duhet te jete ne perputhje me design-in; venia ne perdorim e tij nuk duhet te imponoje domosdoshmerine e nje pune shtese, ose te kerkoje ndryshime ne pune, punen e ndonje Te Kontraktuari tjetere pa pranimin me shkrim nga ana e atij Te Kontraktuari.
- Kerkesat per te gjitha zevendesimet do te shoqerohen nga gjithe informacioni qe i nevojitet Inxhinjerit per te bere vleresimin e duhur.
- Perveç ketyre, I Kontraktuari do te shqyrtoje dhe do t'i paraqese Supervizorit dhe Autoritetit Kontraktues per aprovim te gjitha skicat e projektet qe kane lidhje me ndonje kerkese per zevendesim.
- Te gjithe artikujt dhe paisjet e manufakturuar te zevendesuara, do te aplikohen, instalohen, vihen ne lidhje, ngrihen, perdoren, pastrohen dhe kushtezohen ne perputhje me instruksionet e shtypura te prodhuesit, me perjashtim te rasteve kur specifikohet te veprohet ndryshe.

I Kontraktuari nuk do te kete dhe nuk do te shfaqe ndonje pretendim per nje zgjatje te afatit ose per demtime per shkak te kohes qe eshte dashur per te konsideruar nje zevendesim te propozuar nga I Kontraktuari. Cdo vonese qe krijohet nga shqyrtimi i nje aprovimi per zevendesim do te jete pergjegjesi e vetme e Te Kontraktuarit, i cili ka kerkuar zevendesimin. I Kontraktuari do te organizoje aktivitetet e tij ne menyre te tille qe te rifitoje kohen e humbur.

Pranimi i nje zevendesimi te propozuar ne asnje menyre nuk do ta çliroje Te Kontraktuarin nga ndonje nga kushtet e parashikuara ne Dokumentit te Kontrates.

1.6.3 Ruajtja dhe Mbrojtja e Paisjeve dhe Materialeve

I Kontraktuari do te minimizojë periudhat e magazinimit per materialet dhe paisjet ne Site duke planifikuar qe dorezimi i tyre te koinçidoje me nevojat e punimeve te ndertimit. I Kontraktuari nuk do te magazinoje materiale ose paisje te panevojshme ne Site.

I Kontraktuari do te vendose dhe do te zbatoje shenjat rregullatore per ngarkim-shkarkimin e lejuar neper struktura si dhe masa te tjera sigurie. I Kontraktuari do te marre informacionin e duhur nga prodhuesit qe trajtojne metodat e magazinimit, asamblimit dhe mirembajtjes se artikujve te magazinuar dhe do t'i permbahet atyre kerkesave. Kostot qe mund te gjenerohen per magazinimin, asamblimin dhe mbrojtjen e materialeve dhe paisjeve do te konsiderohen te perfshira ne Kontrate, si rrjedhim nuk do te behet ndonje pagese shtese per keto çeshtje.

1.6.4 Instalimi dhe Testimi i Paisjeve dhe Punimeve

1.6.4.1 Te pergjitheshme

I Kontraktuari do te disponoje personelin e duhur te kualifikuar, paisjet e pershtatshme si dhe makinerite e nevojshme per te realizuar punimet.

I Kontraktuari do te jete pergjegjes per vendosjen, renditjen dhe nivelimin dhe do te angazhoje nje inspektor dhe topograf me eksperience qe te gjitha linjat dhe nivelet te realizohen me saktesine e kerkuar.

Bashke me vizatimet (projektet) ne kantier do te dorezohen edhe instruksionet e plota te prodhuesit, duke perfshire edhe koeficientet e lejueshem te tolerancave (shmangjeve).

Te gjitha punimet do te instalohen ne perputhje me projektet; perfshire edhe specifikimet e prodhuesit, vizatimet dhe tolerancat.

Proçedurat dhe metodologjia e testimit qe do te zbatohen do t'i paraqiten Supervizorit dhe Autoritetit Kontraktues per aprovim perpara se te filloje çdo lloj testimi.

1.6.4.2 Testet ne Pergjithesi

Klauzola te ndryshme Brenda Specifikimeve Teknike percaktojne llojet e testeve qe I Kontraktuari do te kryeje per kontrollin e cilesise se Punimeve, se bashku me frekuencen me te cilen duhet te zhvillohet çdo lloj testi.

Te Kontraktuarit i terhiqet vemendja mbi faktin qe frekuencat e testimeve te specifikuara ne klauzolat perkatese kane si qellim te perfaqesojne vetem nje guide te pergjithshme. Supervizori do te kete te drejte t'i ndryshoje keto frekuenca sipas te cilave behen testet ne se ai/ajo e shikon kete gje te nevojshme per nje kontroll sa me te drejte te cilesise se Punimeve.

Per materialet ose mallrat e manufakturuar I Kontraktuari do te marre Çertifikatat e Testimit te cilat jane perfaqesuese te materialeve ose mallrave te dorezuara nga furnitoret e ketyre materialeve dhe do t'i dergoje Autoritetit Kontraktues dy kopje te çertifikatave. Keto çertifikata do te vertetojne se materialet dhe mallrat perkatese jane testuar ne perputhje me kushtet e Kontrates si dhe do te permbajne rezultatet e te gjitha testimeve te kryera. I Kontraktuari do te vere ne dispozicion menytrat adeguate per identifikimin e materialeve dhe mallrave te dorezuara ne Site me çertifikatat perkatese.

1.6.4.3 Testimi i paisjeve

Testimi i te gjitha paisjeve do te realizohet ne perputhje me kerkesat e te gjitha standarteve perkatese.

Dy kopje te te gjitha çertifikatave te testeve do t'i dorezohen Supervizorit Brenda dy javesh nga çdo testim i vertetuar.

1.7 Çeshtje qe kane te bejne me Ambjentin

Punimet e ndertimit nuk do te shkaktojne ndonje demtim apo shqetesim per publikun dhe per ambjentin. Ky fakt duhet te njihet nga te gjitha palet e interesuara e te perfshira ne Projekt. Si rrjedhim eshte nje kerkese thelbesore qe I Kontraktuari te minimizojte dhe te zbushte impaktet negative te punimeve te ndertimit mbi ambjentin ne respektim te plote te Ligjit Shqiptar si dhe Rregullave te Donatorit.

Gjate realizimit te punimeve I Kontraktuari do t'i permbahet normave dhe rregullave dhe do te zbatohet masat permiresuese si vijon:

- Te reduktojte zhurmen, sidomos ne se punohet ne zona urbane dhe ne afersi te godinave te banuara.
- Te minimizojte shqetsimet e krijuara nga trafiku ne site dhe te ri-vendose aksesin ne banesat rezidenciale.
- Te mbroje nga ndotja lumenjte, liqenet, siperfaqet nen kulture, zonat e mbrojtura dhe zonat ne afersi te site.
- Te marre persiper qe ne perfundim te punimeve te rivendose ne gjendjen origjinale gropat e germimit, kavat e materialeve, shmangjet rrugore ose çdo veper apo pune tjeter provizore parapregatitore.

1.8 Kerkesat per Matjen, Pagesen dhe Miratimin

1.8.1 Matja

Te gjitha punimet do te maten sipas Sistemit S.I. te njesive metrike.

Sasite qe jane percaktuar ne Çertifikaten "Bill of Quantities" te Projektuesit per qellime te analizes se koshtes, konsiderohen si sasi referimi dhe perdoren per krahasimin e Ofertave. Duhet te jete e qarte e te kuptohet drejte se vetem sasite reale te punimeve te kryera apo te materialeve te furnizuara siç jane matur nga Supervizori, do te merren ne konsiderate per pagese.

1.8.2 Pagesat e Ndermjetme

Tarifat ne Kontrate

Gjate llogaritjes se shumes perfundimtare te Kontrates, pagesa do te bazohet ne sasine reale te punes se autorizuar te kryer ne perputhje me Specifikimet dhe Projektet. Do te zbatohen tarifat e specifikuara ne tender, ne varesi te dispozitave te parashikuara ne Kushtet e Kontrates, pavaresisht ne se sasite reale jane me shume ose me pak se sasite e planifikuara.

Kur nga ana e nje Pjesemarresi ne Tender nuk eshte specifikuar ndonje tarife apo çmim per nje artikull te pagueshem ne Bill of Quantities, do te konsiderohet se ai nuk kerkon shperblim per ate pune. Kur, megjithate, nje artikull i pagueshem i pershkruar ne keto Specifikime nuk eshte perfshire ne Bill of Quantities, I Kontraktuari do te marre nje shperblim

te drejte per ate pune ne se eshte e nevojshme, me perjashtim te rastit kur diku tjeter eshte percaktuar e kunderta e kesaj.

Tarifat qe duhet te jene te perfshira

I Kontraktuari do te pranoje pagesen qe percaktohet ne Kontrate dhe qe perbehet nga tarifat e ofruara ne tender nga ai vete ne Bill of Quantities, si nje pagese te plote per zbatimin dhe kompletimin e punes sikurse eshte specifikuar, per prokurimin, furnizimin, vendosjen dhe instalimin e te gjitha materialeve, per prokurimin dhe sigurimin e forces se punes, supervizionit, impianteve, veglave dhe paisjeve, per heqjen e mbeturinave, transportin, ngarkimin e shkarkimin, administrimin, mirembajtjen, punen provizore, testimin, kontrollin e cilesise perfshire kontrollin e proçeseve, shpenzimeve, fitimit, risqeve, dhe detyrime te tjera si dhe per te gjitha rastet e tjera te paparashikueshme te nevojshme per plotesimin e punes dhe mirembajtjes gjate periudhes se mirembajtjes.

Artikujt me Tarife - Fikse

Per nje artikull ne Bill of Quantities per te cilin nuk percaktohet ndonje sasi por kerkohet vetem nje tarife fikse, I Kontraktuari do t'i permbahet nje tarife apo çmimi qe do te perbeje pagesen per punen qe mund te behet ne kuadrin e ketij artikulli. Ky artikull me tarife fikse praktikohet kur mendohet se per kete artikull do te nevojitet shume pak ose aspak pune, ose ne rast se ky artikull duhet te mbahet ne konsiderate si nje alternative per nje artikull tjeter per te cilin eshte percaktuar sasia, ose per variacion te karakteristikave te nje pune te caktuar.

Puna per artikujt me tarife fikse do te paguhet vetem ne rast se eshte realizuar sipas instruksioneve me shkrim nga ana e Inxhinjerit. Faturimi dhe pagesa e artikujve me tarife fikse do te behet vetem ne rast se puna eshte perfunduar ne masen 100%.

1.8.3 Çertifikata e perfundimit te punimeve

I Kontraktuari do t'i kerkoje Supervizorit te leshoje nje *çertifikate per perfundimin e punimeve* sipas Manualit te Proçedurave te ADF dhe Kushteve te Kontrates se Bankes Boterore. *Çertifikata e perfundimit te punimeve* do te leshohet vetem ne se te gjitha pjeset e punimeve jane perfunduar siç duhet dhe deri ne permbushjen e plotpelqimit te Punedhenesit dhe Supervizorit. Punedhenesi do te marre ne dorezim site-n dhe punimet brenda shtate diteve nga leshimi i çertifikates se perfundimit nga ana e Supervizorit.

1.8.4 Pranimi perfundimtar

Data e fillimit te *periudhes se pergjegjesise* per difektet do te perputhet me daten e leshimit te *çertifikates se perfundimit te punimeve*, ne se nuk eshte percaktuar ndryshe ne Kontrate.

Kohezgjatja e *periudhes se pergjegjesise* per difektet eshte percaktuar ne Te Dhenat e Kontrates. *Çertifikata e pergjegjesise per difektet* do te leshohet vetem ne se te gjitha difektet e punimeve jane eliminuar ne menyre adeguate duke permbushur plotpelqimin e Punedhenesit dhe Supervizorit.